



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.33, datë 29.09.2008

**PËR “FINANCIMIN E PJESSHËM TË PROJEKTIT “KUSHTËZIMI I
NDIHMËS EKONOMIKE ME PUNË E SHËRBIME NË KOMUNITET
NË NJËSITË BASHKIAKE NR.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11””**

Në mbështetje të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar), neni 10, pika 3/II gërma “c”, neni 32 gërma “ç”; ligjit nr.8654, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funksonimin e Bashkisë së Tiranës”; ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 për “Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” (i ndryshuar); VKM-së nr.787, datë 14.12.2005 për “Përcaktimin e Kriteve, të Procedurave dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike” (i ndryshuar); VKM-së nr.1114, datë 30.07.2008 për “Disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.05.1993 për “Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), nr.9136, datë 11.09.2003 për “Mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar) dhe nr.7870, datë 13.10.1994 për “Sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar) dhe VKB-së nr.4, datë 25.02.2008 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2008”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë projektin “Kushtëzimi i ndihmës ekonomike të shoqëruar me punë e shërbime në komunitet në Njësitë Bashkiake nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11”.
2. Financimi i këtij projekti do të mbulohet pjesërisht nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2008, në shumën 15.805.500 lekë, nga të cilat:
 - shuma 12.000.000 lekë nga zëri “punë në komunitet” (Artikulli 604);
 - shuma 3.500.000 lekë të përballohen nga fondi i projekteve sociale të Aparatit të Bashkisë së Tiranës;
 - shuma 305.500 lekë të përballohen nga fondet e projektit Qendra Komunitare për të moshuar

3. Në zbatim të pikës 2 të shtohen buxhetet e Njësive Bashkiake nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, sipas Tabelës nr.1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Financë Administratës, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit dhe Njësitë Bashkiake Nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R